



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 5. 7. 2011, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Vjosa Osmani, Blerta Deliu – Kodra, Alma Lama, Blerim Shala, Albert Kinolli dhe Suzana Novobërdali.

Munguan: Fatmir Limaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatore, Safet Beqiri – zyrtar për integritet evropian dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Sanije Berisha, Blerim Vela – OSBE, Besnik Ramadanaj – KDI dhe Arban Abrashi – Kuvendi.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të 21. 6. 2011 dhe të 22. 6. 2011;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
9. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet, si në vijim.

2. Miratimi i procesverbaleve të 21. 6. 2011 dhe të 22. 6. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 22. 6. 2011 me një vërejtje e deputetes Alma Lama, kurse procesverbali i datës 22. 6. 2011 u miratua pa vërejte.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Alma Lama, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Alma Lama – Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për bashkëpunim ndërkomunal dhe partneritete, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputetin Sasha Milosavljeviq, referuese e këtij Projektligji ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Sasha Milosavljeviq – Pas shqyrtimit dhe verifikimit konstatuam se dispozitat e këtij Projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Këshillin Ekonomiko-Social, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL është në harmoni me Acquis Communautaire.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Blerta Deliu-Kodra - Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e regjistrit të të drejtave të pronës së paluajtshme, me amendamentet e Komisionit funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari - Hapi debat për këtë Projektligj, pasi që deputeti, referues i këtij Projektligji, ende nuk kishte arritur në mbledhje.

Blerim Shala – Është shumë me rëndësi të bëhet praktikë të mos miratohen ligje që janë ose mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pra para se të amendamentohet Kushtetuta.

Vjosa Osmani - Vlerësoi se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe se është në kundërshtim me legjislacionin primar të BE-së, sepse parimi i kushtetutshmërisë dhe ai i ligjshmërisë janë parime bazë të legjislacionit të përgjithshëm të BE-së.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në harmoni me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputetin Albert Kinolli, referues i këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Albert Kinolli – Pas shqyrtimit dhe verifikimit u konstatua se Projektligji, së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë në procedurë të rregullt parlamentare për miratim.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

Përfundim

Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për noterinë, me amendamentet e Komisionit Funkcional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga zjarri, me amendamentet e Komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari – E ftoi deputeten Suzana Novoberdali, referuese e këtij Projektligji, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Suzana Novoberdali - Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji për mbrojtje nga zjarri, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis Communautaire.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri